



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-III-12-0476

Paditësi; S S nga Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av S R nga Prizreni.

Kundër

Pala e paditur: K P-Prizren, L –B, Drejtoria në Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rruga „Dritan Hoxha ” nr.55- Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën;19.01.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të vdekjes së parashtruesit të padisë S S, nga Komuna e Prizrenit.
2. Procedura e ndërprerë mund të vazhdohet, kur gjykata i fton të njëjtit ta bëjnë një gjë të tillë.

A r s y e t i m i

Rrjedha procedurale dhe faktike e çështjes

Me datën 04.07.2003, paditësi S S pranë Gjykatës Komunale në Prizren ka parashtruar padi kundër të paditurës K Progres me seli në Prizren, për anulimin e kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë. Gjykata Komunale në Prizren me aktvendimin C.nr.430/03, të datës 21.01.2012, është shpallur jo kompetente për të vendosur në lidhje me këtë çështje juridike kontestimore dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit lëndën ia ka referuar kësaj gjykate.

Pala paditëse në padi ndër të tjera ka theksuar se ka qenë pronar i paluajtshmërisë ngastrës katastrale me nr.5893, në vendin e quajtur G, me kulturë arë e klasit të tretë në sipërfaqe prej 0.49.29 ha, e që evidentohet në listën poseduese me nr.8417, Komuna Kadastrale Prizren.

Në kohën e formimit të kompleksit të tokave shoqërore F e P nga aktivistet e qeverisë se atëherëshme është urdhëruar që pronën e lartcekur t'ia dhuroj të paditurës ose t'ia shes me një çmim shumë të ulët të caktuar nga organet e atëherëshme. Me tuje ka theksuar se në fillim i ka kundërshtuar këto urdhra mirëpo për këtë qëllim ka filluar që të ftohet në zyrat e UDB-es, ku edhe e kanë kërcënuar dhe e kanë keqtrajtuar dhe në këtë mënyrë është detyruar për të lidhur kontratën me palën e paditur. Ka shtuar se kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë e ka lidhur me palën e paditur nën kërcënim dhe se e njëjta është regjistruar pranë Gjykatës Komunale në Prizren Leg.nr.114/63, me datën 16.02.1963. Meqenëse kontrata në fjalë është lidhur nën kërcënim dhe nuk paraqet shprehje të vullnetit të lirë i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e tij ta aprovoj si të bazuar dhe kontrata në fjalë të anulohet dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale të cekur me lartë dhe të detyrohen të paditurat paluajtshmërinë e specifikuar me lartë t'ia bartë në posedim dhe shfrytëzim të lirë.

AKP- si palë e paditur me datën 10.01.2013, pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigje në padinë e parashtruar nga pala paditëse, në përgjigje në padi ndër të tjera ka theksuar se e kundërshton pretendimin e parashtruar nga parashtruesi me padi si të pa bazuar në ligj. Pretendimi i paditësit se ka lidh kontratë nën kërcënim dhe se nuk paraqet vullnet të lirë është i pa qëndrueshëm dhe nuk ka mbështetje ligjore . Kontrata e lidhur nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore, kushtetuese dhe nuk është në kundërshtim me moralin e shoqërisë. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e parashtruar nga pala paditëse ta refuzoj si të pa bazuar.

Me datën 05.10.2022, gjykata ka lëshuar njoftimin në lidhje me caktimin e seancës dëgjimore dhe se nga flete kthesa e njoftimi është njoftuar se pala paditëse ka vdekur.

Arsyetimi Ligjor

Me nenin 277 paragrafi 1 pika a) e Ligjit për Procedurën Kontestimore është e përcaktuar se procedura kontestimore ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale. Në rastin konkret nga të dhënat e shkresave të lëndës gjykata ka konstatuar se pala paditëse ka vdekur dhe se bazuar në dispozitën e lartë cekur dhe gjendjen faktike gjykata ka vendosur si në paragrafin “I” të dispozitivit të këtij aktvendimi. Pastaj me nenin 280 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është e përcaktuar se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata. Rrjedhimisht duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata ka vendosur si në paragrafin “II” te dispozitivit të këtij aktvendimi.

Përfundimisht nga rrethanat e lartcekura, e duke u bazuar në nenin 277, paragrafi 1 pika a) të LPK-së dhe nenit 280 paragrafi 1, të të njëjtit ligj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej; 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit i këtij aktvendimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi